



# “Askund si në shtëpi” - a

Daut DAUTI

## Balta më e ëmbël se mjalta

Në kapitullin e parë të Librit “Shtëpitë dhe Kopshtet” dokumentohet e padukshmjia gjatë viteve 1994-95, siq e quan autorja ndryshe këtë kapitull. Ky kapitull përfshinë shumicën e fotografive të cilat Melanie i kishte botuar më herët në librin po më këtë titull. Në kapitullin e dytë, të titulluar: Asgjë, Asgjë, paraqitet jeta e shqiptarëve të debuar në kampet e Maqedonisë. Kapitulli i tretë ka të bëjë me fotografitë e Reçakut, Lubizhdës dhe Celinës që titullohet: Udhërrëfimi. Ndërsa kthimi i shqiptarëve të dëbuar nga vatrat e tyre paraqitet në kapitullin e katërt të cilën autorja e quan: Edhe balta në vendin tënd është më e ëmbël se mjalti në vendin e huaj. Jeta e minoriteteve në Kosovën e pasluftës paraqitet në kapitullin e pestë me titull: Një lloj burgu. Kapitulli i gjashtë titullohet: Vdekja është më afër se këmisha, kurse kapitulli i fundit emërohet: E kaluar e tashme në të ardhshmen.

Në vjeshtën e vitit 1996 pata nderin që Melanie Friend të më dhuronte një kopje të librit të saj “Homes and Gardens” (Shtëpitë dhe Kopshtet). Pas shfletimit të librit, vetëm atëherë, e pata të qartë sa kisha humbur që nuk e kisha vizituar ekspozitën e fotografive të saja në Londër që ishte organizuar disa javë para se ta kisha librin në dorë.

Nga libri shifej se për shkak të pamundësisë dhe rrezikut të madh nga policia serbe Melanie Friend nuk kishte patur mundësi ta ushtronte profesionin e fotoreporteres në mënyrë të zakonshme. Megjithatë, Melanie kishte vendosur të mos dorëzohej. Prandaj, kishte vendosur që të fotografonte vendet pas ngjarjeve, gjegjësisht pas ndodhjes së krimeve të serbëve. Ndikim të madh të autorja kishin lënë shtëpitë dhe kopshtet shqiptare në Kosovë. Shumica e këtyre shtëpive dhe kopshteve të fotografuara kishin të bëjnë me viktimat e një politike brutale ndaj shqiptarëve. Në “Homes and Gardens”, në mënyrë unike, paraqitet realiteti i asaj kohe të vështirë në Kosovë. Kopshtet dhe shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës, nga fotografitë, vëreheshin se janë shumë më ndryshe se ato të britanikëve.

Gjurmët e kriminelëve, edhe pas tendencave për t'u fshehur, mbesin dhe dalin në dritë nga puna e autores. Në fotografitë e “Homes and Gardens” ajo që vërehet dhe që kap vëmendjen menjëherë, për ta mbajtur gjatë në kujtesë, është pastërtia dhe rendi i shtëpive dhe kopshteve të cilën autorja insiston ta paraqet si dominuese. Qetësia e natyrës, e paraqitur në fotografitë e periudhës së paraluftës, paralajmëron pasigurinë, njësoj sikur edhe në portretet e njerëzve.

Por, ajo që mua më së shumti ma kishte kapluar imagjinatën, por më shumë ndjenjat, ishte

fotografia e Miradije Aliut. Kjo grua qëndronte ulur në shtrat të dhomës së saj (të fjetjes) me një qëndrim të denjë. Në fytyrën e saj vërehej një pasiguri apo brengosje për ardhmërinë. Bukuria, fuqia shpirtërore dhe dinjteti i saj janë elemente që në mënyrë të fuqishme bëjnë me dije prezencën e figurës së saj madhështore. Ky është portreti i nënave tona kosovare.

## Dinjteti në ekuilibër


Melanie Friend përsëri kishte vizituar Kosovën mu në prag të tmerreve të fillimit të vitit 1999 nga ku kishte sjellë pamjet tjera. Tmerri kishte ndodhur dhe Melanie vjen përsëri për të vizituar vendet ku ishin vendosur shqiptarët e dëbuar me të cilët ajo tashti kishte themeluar jo vetëm relacionet profesionale por edhe ato humane. Në grupin e këtyre fotografive paraqitet përsëri Miradija. Ajo tashti është në Stankovec. Ulur, nën tendë, fytyra e saj shpreh arësyeshmërinë e brengave të saja që i kishte para disa viteve. Në fytyrën e saj të pastër dhe të bukur prore, vërehet tmerri i përjetuar, frika, droja ... Megjithatë, dinjteti është në ekuilibër.

Melanie, për të kompletuar punën e saj, në mënyrë morale dhe profesionale, përcjell edhe kthimin e refugjatëve në shtëpitë e tyre. Përsëri Miradije Aliu. Ajo tashti qëndron në shtëpinë e djegur. Nga fytyra e saj tashti vërehet një luftë në mes ndjenjave të pikëllimit dhe shpresës. Në këtë luftë ndjenjash shpresa dominon vazhdimisht duke i dhënë dinjtetit kredibilitet më të madh.

Këto tri pamje flasin fuqishëm për qëndrueshmërinë e shqiptarëve gjatë së kaluarës dhe shpresës për të ardhmen që ka populli në Kosovë.

Përfundimi i librit flet për kujdesin dhe dashurinë që ka Melanie Friend për profesionin e saj. Një dashuri e tillë dhe një respekt vërehet edhe për banorët e Kosovës. Libri përfundon me një fotografi të plakut 74 vjeçar, Ali Hyseni, i përcjellë me një shkrim të shkurtër tejet filozofik, praktik dhe i arësyeshëm që ka ky plak për të kaluarën, të tashmen dhe për të ardhmen e Kosovës, vendit të tij. Edhe pas gjithë tmerreve të përjetuara, plakun nuk e ka humbur dashurinë për Kosovën dhe arsyen dhe vullnetin jetë dhe për të ardhmëri. Edhe një herë, si gjithmonë, Melanie Friend e vërteton talentin e saj të rrallë për fotografi. Ky plak 74 vjeçar, por me plot fuqi, shëndet dhe madhështi, qëndron fuqishëm mbi tokën me lule të sapoçelura ku në prapavijë vërehen shtëpitë po ashtu të spondërtuara. Qielli, simboli i lirisë, zë hapësirën më të madhe të fotografisë. Plaku qëndron me dinjtet duke bërë qartë me dije se kush është zoti i kësaj toke.

Libri është është botuar para disa javësh në SHBA. Këtë libër autorja ua dedikon miqve të saj në Kosovë. Fotografitë dhe teksti që përbëjnë tërësinë e librit ndahen në 7 kapituj.



# o dashuria për atdheun

Melanie Friend, gazetare britanike, për herë të parë e ka vizituar Kosovën në vitin 1989. Libri i saj, "No Place Like Home" (Askund si në shtëpi), me fotografi dhe fjalë, që ka të bëjë me Kosovën, autoren e bënë fotografe (fotoreportere) të jashtëzakonshme.

Fotografitë e autores në fjalë janë botuar në revistat dhe gazetatat më me renome në botë. Po ashtu, këto fotografi janë ekspozuar në shumë ekspozita ndërkombëtare të galerive më të njohura të botës. Puna e saj e vërteton thënien se fotografitë janë më të fuqishme dhe flasin më shumë se fjalët. Libri "No Place Like Home" është një dëshmi personale e autores, për periudhën e fundit dhjetëvjeçare, të cilën ajo ia ofron lexuesit me fjalë por më shumë me fotografi. Kjo vepër në mënyrë të veçantë paraqet një histori të llojit të vet të dekadës së fundit të Kosovës. Rrëfimet dhe fotografitë janë rrëfime mbi dashurinë dhe lidhjen e fortë e të pakëputur që kanë shqiptarët për shtëpinë dhe atdheun. Mënyra e saj e shprehjes së kompleksit të mënyrës së jetesës dhe situatës së përgjithshme në Kosovë, autoren e bën artiste (me fotografi) dhe gazetare (me shkrim) të shkëlqyeshme.

